




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI

URDHËR

*"për vënien e sekuestros konservative"*



Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Për dijeni: Shoqëria "MUKA 1741" shpk me NIPT L93623203L dhe Shoqëria "MUKA KONFEKSION" shpk me NIPT L92423026G

Për dijeni: Banka Credins sh.a

Pranë Zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Besnik DOKUSHI me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbareme me palë:

Debitorit : Shoqëria "MUKA" shpk me NIPT K22008002D ndarë ne Shoqërinë "MUKA1741" shpk dhe Shoqëria "MUKA KONFEKSION" shpk  
Dorëzanës : Belma Burhan Muka e dtl.08.08.1972, Gilman Imudedin Muka i dtl.10.02.1965  
Hipotekues : Gilman Imudedin Muka i dtl.10.02.1965  
Kreditorit : Banka CREDINS sh.a  
Objekti : Kredi Bankare

Unë Përmbaruesi Gjyqësor privat Besnik DOKUSHI pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbareme,

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Kontratë Kredie Afatgjatë Nr.2042, Nr.1177Rep, Nr.564Kol, datë 09.03.2016, të lëshuar nëpërmjet Bankës Credins në cilësinë e kredidhënësit, Shoqëria "MUKA" shpk me NIPT K22008002D në cilësinë e kredimarrësit, Belma Burhan Muka e dtl.08.08.1972 dhe Gilman Imudedin Muka i dtl.10.02.1965 në cilësinë e dorëzanësve është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Nr. 7694 Akti, datë 04.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt:

*"Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv Kontratë Kredie Afatgjatë Nr.2042, Nr.1177Rep, Nr.564Kol, datë 09.03.2016"*

Në datën 26.12.2019 në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e bllokimit në kuotat e palës debitore Shoqëria "MUKA" shpk me NIPT K22008002D.

**Per kete arsye:**

Si dhe në bazë të neneve 519 të K.Pr.Civile,

URDHEROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë verifikimin dhe bllokimin e kuotave të debitorit Shoqëria "MUKA 1741" shpk me NIPT L93623203L dhe Shoqëria "MUKA KONFEKSION" shpk me NIPT L92423026G si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe ose disponimin e tyre dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**  
**PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI**

3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet ne 5 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR  
BESNIK DOKUSHI

